



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2022:176387

Datë: 06.10.2023

Numri i dokumentit: 04764441

P.nr.2213/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në lëndën penale të akuzuarve G. U., I. Sh. dhe B. I. të gjithë nga M., të akuzuar për veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1346/2022 të datë 29.08.2022, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 26.09.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Lulzim Aliu dhe të akuzuarve G. U., I. Sh. dhe B. I., me datë 29.10.2023 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 06.10.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

- G. U., i biri i R. dhe nëna B., e gjinisë T., i lindur me ..., në M., me vendbanim në rr. “M. T.” – M., me numër personal ..., të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetase e Republikës së Kosovës.
- I. Sh., i biri i H. dhe nëna A., e gjinisë I., i lindur me ..., M., me vendbanim në Rr. “A. R.” në M., me numër personal ..., të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetase i Republikës së Kosovës dhe
- B. I., i biri i A. dhe nëna R., e gjinisë I., i lindur me ..., M., me vendbanim në L. T. M. Rr. “A. R.”, me numër personal ..., të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetase i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse:

Me datë 02.10.2021, rreth orës 19:40, në rrugën magjistrale P.-M., saktësisht në fshatin M. të O., të pandehurit kanë poseduar substancë narkotike në atë mënyrë që zyrtaret policor pasi kishin ndaluar automjetin A. ngjyrë e zezë me targa ... në të cilin ishin të pandehurit dhe se gjatë

kontrollit në veturë kishin gjetur substancë narkotike të llojit marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 1.30 gram.

- Me këtë secili veç e veç kanë kryer veprën penale *Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge* nga neni 269 par 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 69, 70, 71, 72, 81, 82 dhe 269 par 2 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarve secilit veç e veç i' u shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

- I. Në bazë të nenit 269 par.3 të KPPRK-së konfiskohet substanca narkotike e llojit Marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 1.30 gram
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, URDHËROHET asgjësimi i substancës së cekur në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorinë.
- III. Obligohen të akuzuarit secili veç e veç që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguajnë shumën prej 20 (njëzet) në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr.1346/2022 të datë 29.08.2022, ndaj të akuzuarve G. U., I. Sh. dhe B. I. për shkak të dyshimit të bazuar mire se kanë kryer veprën penale *Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge* nga neni 269 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penalo juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 26.09.2023, në prani të Prokurorit të Shtetit, Lulzim Aliu dhe të akuzuarve G. U., I. Sh. dhe B. I., ku të akuzuarit pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, e kanë pranuar fajësinë për veprën penale *Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge* nga neni 269 par 1 të KPRK-së, dhe se deklarojnë se e ndjen vetën fajtor, shpreh keqardhje për këtë veprim dhe se i premtan gjykatë se nuk do të përsërit veprimin e njëjtë. Po ashtu i kanë deklaruar Gjykatës, se nuk janë përdorues të substancave narkotike dhe është hera e parë që janë përpara Gjykatës të akuzuar për vepër penale.

Pas deklarimit të akuzuarit, mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, pasi që një pranim i tillë bëhet në mënyrë vullnetare dhe se janë të vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë si dhe ky pranim i fajësisë është në përputhje të plotë me provat dhe gjendjen faktike si ne aktakuzë. Gjykata konstatoj se të akuzuarit e pranojnë fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, të akuzuarit janë të vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë për të cilat është njoftuar nga Gjykata, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 242 par. 2 të KPPRK-se janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë ne këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarve se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara si: Raporti fillestar i incidentit me numër 2021-AJ-0341, i datës 02.10.2021; Raporti i policit V. Z. #..., i datës 02.10.2021; Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dyshuarit G. U., i datës 02.10.2021 dhënë në Stacionin Policor në Obiliq; Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dyshuarit I. Sh., i datës 02.10.2021 dhënë në Stacionin Policor në Obiliq; Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dyshuarit B. I., i datës 02.10.2021 dhënë në Stacionin Policor në Obiliq; Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datës 02.10.2021; Raport i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, i datës 16.12.2021 si foto dhe provat tjera që gjenden të bashkangjitura në lëndë, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, rrjedh se në veprimet e të akuzuarve G. U., I. Sh. dhe B. I. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të akuzuarit e kanë kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarve, kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarit, gjykata ka vlerësuar faktin se të njëjtit kanë treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier të përgjegjshëm për veprimet e tyre dhe duke shprehur keqardhje për veprën që e kanë kryer. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi të akuzuarve, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka gjetur faktin e rrezikshmërisë së lartë shoqërore të këtyre veprave penale.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim të nenit 82 të KPRK-se të akuzuarve i gjykoj si ne dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarve është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit ne pengimin e të pandehurve ne kryerjen e veprave penale ne të ardhmen veçanërisht llojin e njëjte të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 €.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 361 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.2213/22 më datë 06.10.2023

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.